



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 115/13
Prishtinë, më 11.07.2013, ora 14:30
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllani, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj Sevdije Lama dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Rejhane Zylfijaj, Njomza Ilazi nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-209 për Amenstinë me Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion;

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-209 për Amenstinë

Kryetarja theksoi se tashmë jemi të njftuar se projektligji për amenstinë kaloi në lexim të parë në Kuvend, dhe është kërkuar komisione kryesore të shqyrtojnë me procedurë të shpejtë. Nëse e marrim edhe e shikojmë deklaratën financiare të Departamentit të Buxheti të Ministrisë së Financave, kuptojmë se projektligji, si i tillë nuk prodhon një kosto shtesë buxhetore. Komisioni funksional për legjislacion nuk ka propozuar ndonjë amendament.

Naser Osmani për me qenë korrekt si deputet edhe si anëtarë i komisionit, duhet sqaruar se ne e kemi vetëm deklaratën e qeverisë, që thotë se projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë, dhe nuk kemi ndonjë dokument tjetër apo mekanizëm që do të kishim mundur të verifikojmë sasinë e kostos buxhetore. Ne nuk mundur të bëjmë një raport që të precizohen saktësisht implikimet buxhetore, sepse është një ligj që buron nga marrëveshje politike, e konsideroj ligj politik, dhe ne vetëm e përcjellim për seancë.

Albana Fetoshi theksoi se projektligji përmban implikime financiare shtesë dhe nuk mundemi kështu urgjentisht të kalojmë këtë qështje, siç është thirrur mbledhja, do të duhej të shtyhej mbledhja dhe të kemi kohë për analizë të neneve që përmbajn implikime buxhetore shtesë. Qeveria ka konstatuar se nuk ka

kosto financiare shitesë, por dikush është ka na gënjen dhe ajo është Qeveria, që na ka thënë se nuk ka kosto financiare, por realisht ka kosto financiare.

Kryetarja pyeti deputeten Fetoshi, nëse ka ndonjë propozim konkret lidhur me nenet e projektligjit, sa i përket koston financiare shitesë?

Albana Fetoshi theksoi se kërkohet kohë për të analizuar nenet e projektligjit dhe për të vlerësuar koston buxhetore shitesë, dhe është e nevojshme të shtyhet mbledhja dhe mos të kalojë kjo qështje urgjente.

Sali Asllanaj rmendoj që projektligji nuk ka kosto financiare shitesë, përkundrazi lirohen disa mjetet buxhetor, me lirim e të burgosërve që parasheh projektligji, kur dihet se për një të burgosur, qëndrim ditor ne burg është 28 euro në ditë. Mua nuk po duket e logjikshme mendimi për koston shitesë financiare dhe e arsyeshme me e shtye mbledhjen.

Pas diskutimeve, Komisionit me nëntë vota Për (Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllani, Xhevdet Neziraj Sevdije Lama dhe Duda Balje, dy Kundër (Hykmete Bajrami dhe Albana Fetoshi) dhe asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-209 për Amenstinë, nuk përmban implikime buxhetore shitesë.

Mbledhja përfundoi: 14:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj